

VENDIM
Nr. 132, datë 7.7.2025

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 157, DATË 31.7.2024 “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘H.K. HEC GRABOVA 2’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 1911/1 prot., datë 1.7.2025 “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 157, datë 31.7.2024 ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘H.K. HEC Grabova 2’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike””,

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “H.K. HEC Grabova 2” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 157, datë 31.7.2024, ka licencuar shoqërinë “H.K. HEC Grabova 2” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Grabova 2”, me kapacitet total të instaluar 10.8 *mw*, me vendndodhje në pellgun e përroit të Grabovës, Gramsh, qarku Elbasan, duke filluar ky afat nga data 24.10.2024 deri më 14.9.2052.

- Në dispozitivin e këtij vendimi, ERE ka vendosur që shoqëria “H.K. HEC Grabova 2” sh.p.k. të depozitojë në ERE qëndrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe/ose amendimin e kontratës së nënshkruar, në lidhje me kërkesën e saj për zgjatjen e afatit të datës së fillimit të operimit të hidrocentralit “Grabova 2”. Gjithashtu, është kërkuar që shoqëria të dorëzojë në ERE kontratën e kredisë së rishikuar, të nënshkruar me “Raiffeisen Bank” sh.a., brenda muajit tetor 2024. Ky vendim do të jetë objekt rishikimi nga ERE në varësi të depozitimit të dokumentacionit të sipërpërmendur.

2. Kërkesa e shoqërisë dhe dokumentacioni i depozituar

- Shoqëria “H.K. HEC Grabova 2” sh.p.k., me shkresën nr. 50 prot., datë 20.6.2025, protokolluar në ERE me nr. 1911 prot., datë 20.6.2025, ka kërkuar shfuqizimin e pikës 3 të vendimit nr. 157, në funksion të përmbushjes së këtij kushti.

- Me shkresën nr. 90 prot., datë 18.10.2024, protokolluar në ERE me nr. 996/12 prot., datë 18.10.2024, shoqëria ka depozituar kontratën e kredisë së nënshkruar me “Raiffeisen Bank” sh.a., me nr. 6896 repertori, nr. 2851 koleksioni, datë 17.9.2024.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Në përputhje me nenin 9, pikën 1.2, germën “b” të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, aplikuesit janë të detyruar të dorëzojnë dokumente që vërtetojnë mbështetjen financiare për realizimin e projektit.

- Nga shqyrtimi i kontratës së depozituar, rezulton se kjo kontratë përmban elementët themelorë të mbështetjes financiare për ndërtimin dhe vënien në punë të hidrocentralit “Grabova 2”, duke përmbushur kërkesat e përcaktuara në rregullore.

- Kontrata është dorëzuar brenda afatit të përcaktuar në pikën 3 të vendimit nr. 157/2024, çka përbën përmbushje të plotë të detyrimit të vendosur nga Bordi i ERE-s.

- Megjithëse shoqëria “H.K. HEC Grabova 2” sh.p.k. ka përmbushur kushtin e përcaktuar në pikën 3 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 157, datë 31.7.2024, dhe ka depozituar në afat kontratën e kredisë së nënshkruar me “Raiffeisen Bank” sh.a., kushti i përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi vijon të

mbetet në proces verifikimi. Deri në këtë fazë, ERE nuk ka administruar ende qëndrimin zyrtar të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe/ose amendimin e kontratës koncensionare lidhur me kërkesën për zgjatjen e afatit të fillimit të operimit të hidrocentralit.

- Për rrjedhojë, ERE do të vijojë korrespondencën me shoqërinë “H.K. HEC Grabova 2” sh.p.k., për të ndjekur përmbushjen e këtij detyrimi, në mënyrë që të sigurohet respektimi i kërkesave të vendimit nr. 157/2024 dhe të kuadrit rregullator përkatës.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në funksion të sa parashtruar më sipër, vlerësohet se kushti i vendosur në pikën 3 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 157, datë 31.7.2024, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘H.K. HEC Grabova 2’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, është përmbushur nga ana e shoqërisë dhe si i tillë duhet të shfuqizohet.

- Si rrjedhojë e shfuqizimit të pikës 3 të dispozitivit të vendimit nr. 157/2024, vlerësohet të ndryshojë dhe pika 4 e këtij vendimi, e cila do të formulohet si vijon: *“Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të depozitimit të dokumentacionit të përcaktuar në pikën 2 të tij.”*

- Bazuar në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ku përcaktohet se një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj, vlerësojmë që pika 3 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 157, datë 31.7.2024, duhet të shfuqizohet pasi shoqëria “H.K. HEC Grabova 2” sh.p.k. ka përmbushur kushtin e vendosur nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 3 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 157, datë 31.7.2024, shfuqizohet.
2. Pika 4 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 157, datë 31.7.2024, ndryshon si më poshtë vijon: *“Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të depozitimit të dokumentacionit të përcaktuar në pikën 2 të tij.”*
3. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë shoqërinë “H.K. HEC Grabova 2” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, FTL sh.a., OSSH sh.a. lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

